

Parandalimi

- Fillim i jetës seksuale në moshë më të madhe
- Praktikimi i seksit të sigurt (përdorimi i prezervativëve - kondomit)
- Evitimi i numrit të madh të partnerëve seksual
- Kontrollë gjinekologjike të rregullta
- Vaksinim kundër HPV

Kontrollët e rregullta gjinekologjike kanë për qëllim zbulimin e hershëm të ndryshimeve të mitrës. Gjatë kontrollit gjinekologjik merret strishio nga qafa e mitrës e më pas analizohet në laborator për të parë nëse ka ndryshime të qelizave (PAP testi).

ÇFARË ËSHTË PAP TESTI?

PAP testi është një test i shpejtë për kontrollimin e shëndetit të qafës së mitrës. Testi është pjesë e një kontrolli të zakonshëm gjinekologjik. Me një shkophth druri merret strishio nga sipërfaqja e qafës së mitrës dhe kanali endocervikal që pastaj vendoset në një copë qelqi që lyhet me ngjyrë dhe që shihet nën mikroskop.

Gratë duhet të bëjnë kontroll gjinekologjik preventiv së paku një herë në vit.

Përmes Programit për skringing të Ministrisë së shëndetësisë ju mund të bëni një PAP test falas!

Në vitin 2018 me këtë skringing përfshihen gratë në moshë nga 24-35 vjet, si dhe gratë në moshë nga 36-60 të cilat gjatë vitit 2017 nuk kanë bërë PAP testin.

PËR MË SHUMË INFORMACION DREJTOHUNI GJINEKOLOGUT TUAJ AMË DHE BËJENI KONTROLLIN SA MË SHPEJTË!

Sepse shëndeti duhet të jetë gjëja më me rëndësi.

Kanceri i qafës së mitrës mund të shërohet me sukses nëse zbulohet në kohë.



Republika e Maqedonisë
Ministrie e shëndetësisë



Instituti i shëndetit publik i
Republikës së Maqedonisë



BËNI PAP TESTIN!



PËRSE?

Kanceri i qafës së mitrës është një nga sëmundjet malinje më të shpeshta si në botë ashtu edhe tek ne. Në mbarë botën, kanceri i qafës së mitrës është tumori malinj i tretë me radhë që përfshin 8.8% të të gjitha llojeve të kancerit tek gratë. Në Evropë nga kanceri i qafës së mitrës brenda një viti sëmuren 65.000 gra, ndërsa rreth 32.000 vdesin.

Në Republikën e Maqedonisë shkalla e rasteve të reja me kancer të qafës së mitrës është 22.5 në 100.000 banorë, ndërsa në vit vdesin rreth 40 gra.



Kanceri i qafës së mitrës, qafa e mitrës

Qafa e mitrës është pjesa e poshtme me mitrës që është e kthyer kah vagjina.

Kanceri në fakt paraqet ndryshim të qelizave të qafës së mitrës dhe shumimin e tyre të pa-kontrolluar. Zakonisht atij i paraprin paraqitja e ndryshimeve para-malinje – para-kanceroze (CIN 1,2,3) që mund të tërhiqen spontanisht ose të kalojnë në kancer. Që gjendja të kalojë nga para-kaceroze në kancer ndonjëherë duhet të kalojnë edhe deri në 10 vjet.

Faktorët e rrezikut

Prania e disa llojeve të caktuara të Human Papilloma virusit (HPV) lidhet me shfaqjen e kancerit të qafës së mitrës. HPV përcillet gjatë kontaktit seksual.

Rreziku nga paraqitja e kancerit të qafës së mitrës rritet tek femrat të cilat kanë ndonjë infeksion tjetër seksualisht të transmetueshëm, të cilat pinë duhan, kanë numër të madh të partnerëve seksual, numër të madh të shtatzënive, që përdorin për një kohë më të gjatë kontraceptivë oral ose që kanë imunitet të dobët.

Simptomat e kancerit të qafës së mitrës

Në fillim zakonisht nuk ka kurrfarë simptoma të sëmundjes, mund të paraqitet sekrecion vaginal me gjak, ose gjakosje gjatë kontaktit seksual, dhimbje gjatë kontaktit seksual, dhimbje në pjesën e poshtme të barkut, dhimbje të kockave, lodhje kronike, ënjtje e këmbëve..